



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 281/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković-Kryetar, Panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Auto Xani – Bujar Stublla” pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me tenderin “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve “Lot 4 me nr.prok:616-19-1046-2-2-1, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve “Lot 4 me nr.prok:616-19-1046-2-2-1 të iniciuar nga AK- KK- Prishtinë, më datë: 25.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Auto Xani – Bujar Stublla” Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve” Lot 4 me nr.prok:616-19-1046-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtinë.

II. ANULOHET, Vendimi i AK-së- Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve “ me nr. prokurimit: 616-19-1046-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Auto Xani – Bujar Stublla" Podujevë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 11.03.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 08.04.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 08.04.2019.

Data njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me dt: 23.05.2019.

Letra standarde për Operoret Ekonomik si tenderues të eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 23.05.2019.

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit operatori ekonomik: "Auto Xani – Bujar Stublla" Podujevë, me dt: 24.05.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt 27.05.2019, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "Auto Xani – Bujar Stublla" Podujevë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "Auto Xani – Bujar Stublla" Podujevë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.06.2019, me nr. 281/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve" Podujevë me nr. prokurimit: 616-19-1046-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK-Prishtinë duke pretenduar në shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së:

- Shkelje të nenit 6 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës;
- Shkelje të nenit 7 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës;
- Shkelje të nenit 52 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës;

- Shkelje te nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës;

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues profesional në raportin e dt.26.06.2019, ka konstatuar se:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimet e OE ankues, janë se AK Kuvendi Komunal i Prishtinas ka bërë shkelje te nenit 6 .7 .52 dhe 69 te LPP ne fuqi, sepse AK e ka eliminuar Operatorin ekonomik ankues me pretendimin se nuk i plotëson kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale konkretisht nuk e posedon kategorinë e vozitjes D1 dhe D dhe nuk e plotëson kërkesën për minibus sepse sipas Ligjit për komunikacion Neni 3 pika 1.8 Automjet udhëtarësh -mjet qe shërben për transport te personave i cili përveç ulëses se shoferit ka me se shumti 8 ulëse , ndërsa ju keni ofruar mjetin për transport 8+1 ulëse. Expertja profesionale e prokurimit konstaton se pretendimet e OE Ankues janë te bazuara për arsye se AK Komuna e Prishtinës tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nuk ka cekur numër te ulëseve vetëm ka kërkuar Operatori Ekonomik duhet te posedoj se paku 1 minibus për një linje (LOT), por vetëm ne përshkrimin e Çmimeve është e specifikuar qe do te barten 8 nxënës , pastaj e ka eliminuar OE se nuk e plotëson këtë kriter sepse kategoritë qe duhet ti ketë Patente shoferi i OE duhet te jene Kategoria D1: 1.12.1. automjete të dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të jo më shumë së gjashtëmbëdhjetë (16) udhëtarëve dhe të shoferit, ku gjatësia maksimale e tyre nuk e tejkalon gjatësinë prej tetë (8) m; automjetit mund t'i bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg; ose kategoria D:1.14.1. automjetet e dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të më shumë së tetë (8) udhëtarëve dhe shoferit; mund t'iu bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg.. Operatori ekonomik ka ofruar patente shoferin e kategorisë B dhe automjetin me 9 ulëse e duke u nisur nga kërkesa e AK për bartjen e 8 nxënësve Sipas Ligjit Ligji Nr. 05/L - 064 për patentat shofer nuk është e nevojshme ti ketë këto dy kategori sepse Kategoria B:e 1.6.1. automjeti me masën më të madhe të lejuar deri në 3500 kg, dhe i projektuar e i dizajnuar për transportim të jo me shumë se tetë (8) udhëtarësh, përveç shoferit. Automjetit në këtë kategori mund t'i bashkëngjitet një rimorkio e cila është me masën më të madhe të lejuar (maksimale të autorizuar) deri në 750 kg; e plotëson këtë kriteret Autoriteti Kontraktues . Gjithashtu mjeti transportues i ofertuar nga OE me 9 ulëse është në pajtim me LIGJIN Nr. 05/L-088 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR, neni 3 paragrafi 1.8 Automjet udhëtarësh - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetë (8) ulëse.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues Autotaxi “Bujar Stublla”-Podujeve të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), të anulohet Njoftimi mbi vendimin e AK dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.06.2019 , ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues “Auto Xani – Bujar Stublla” përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019 ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, eksperti shqyrtues profesional, përfaqësuesi i OE ankues përfaqësuesi i autoritetit kontraktues nuk ka marr pjesë në seancë edhe pse i njëjti është fluar me ftesë të rregullt dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës, andaj seanca u mbajt me praninë e palëve prezentë ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Stublla deklaroi: Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve tona ankimore si dhe pajtohemi me mendimin dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Doda deklaroi: Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se AK e ka eliminuar Operatorin ekonomik ankues me pretendimin se nuk i plotëson kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale konkretisht nuk e posedon kategorinë e vozitjes

D1 dhe D dhe nuk e plotëson kërkesën për minibus sepse sipas Ligjit për komunikacion Neni 3 pika 1.8 Automjet udhëtarësh -mjet që shërben për transport të personave i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti 8 ulëse , ndërsa ju keni ofruar mjetin për transport 8+1 ulëse.

Paneli shqyrtues skonform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara për arsye se AK Komuna e Prishtinës tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nuk ka cekur numër të ulëseve vetëm ka kërkuar Operatori Ekonomik duhet të posedojë së paku 1 minibus për një linjë (LOT), por vetëm në përshkrimin e Çmimeve është e specifikuar që do të barten 8 nxënës , pastaj e ka eliminuar OE se nuk e plotëson këtë kriter sepse kategoritë që duhet të ketë Patente shoferi i OE duhet të jenë Kategoria D1: 1.12.1. automjete të dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë (16) udhëtarëve dhe të shoferit, ku gjatësia maksimale e tyre nuk e tejkalon gjatësinë prej tetë (8) m; automjetit mund t'i bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg; ose kategoria D:1.14.1. automjetet e dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të më shumë se tetë (8) udhëtarëve dhe shoferit; mund t'i bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se operatori ekonomik ka ofruar patente shoferin e kategorisë B dhe automjetin me 9 ulëse, andaj e duke u nisur nga kërkesa e AK-së për bartjen e 8 nxënësve Sipas Ligjit Ligji Nr. 05/L - 064 për patenta shofer nuk është e nevojshme të ketë këto dy kategori sepse Kategoria B:e 1.6.1. automjeti me masën më të madhe të lejuar deri në 3500 kg, dhe i projektuar e i dizajnuar për transportim të jo më shumë se tetë (8) udhëtarësh, përveç shoferit. Automjetit në këtë kategori mund t'i bashkëngjitet një rimorkio e cila është me masën më të madhe të lejuar (maksimale të autorizuar) deri në 750 kg.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se gjithashtu mjeti transportues i ofertuar nga OE me 9 ulëse është në pajtim me LIGJIN Nr. 05/L-088 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR, neni 3 paragrafi 1.8 Automjet udhëtarësh - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetë (8) ulëse.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44 të RrUOPP.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna e Prishtinës

1x1 OE - "Auto Xani – Bujar Stublla"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.